



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nr 1735 Prot.

Gjirokastrë, më 14/12/2018

DEKLARATË E SENATIT AKADEMIK TË UGJ

Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë në mbledhjen e tij të datës 14.12.2018 (ku pati të ftuar dhe një grup studentor nga protestuesit), u shpreh unanimisht në mbështetje të kërkesave të tyre të paraqitura në rektorat më 12.12.2018 me zgjidhjet si më poshtë;

1. Të realizoj gjatë vitit 2019 përmirësimin e infrastrukturës me investime për:
 - a. ristrukturimin e sallës e mediatekës,
 - b. blerjen e dy laboratorëve të rinj
 - c. një sallë shtesë dhe aspirim për bibliotekën,
 - d. mobilimi dhe ristrukturimi i 50% të auditorëve mësimor ekzistues,
 - e. shtimi i shtatë auditoreve të rinj në ish shtëpinë e ushtarakëve me fondet e universitetit,
 - f. shtimi i orëve me ngrohje.
2. Të rrit fondet për aktivitetet studentore në masën 50%.
3. Në funksion të cilësisë, në tërësinë e komponentëve universitar (mësimor, shkencor, infrastrukturor etj.), para çdo vendimmarrje, strukturat e universitetit do të konsultohen me përfaqësitë studentore të njësive kryesore dhe të institucionit.
4. Do të mbështetet çdo lëvizje studentore që i shërben rritjes së cilësisë në UGJ



KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

PROF.DR. BEKTASH MEMA

